

## STATUTI

### I SHOQERISE " CURRUNT" shpk "

KRIJIMI, FORMA, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, EMERTIMI, SELIA

#### NENI 1

##### KRIJIMI I SHOQERISE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " CURRUNT" shpk " eshte krijuar ne baze te aktit te themelimit nga ortaku i meposhtem:

**Z. Renato BONORA**, biri i Lorenzos , lindur me 20/11/1947, ne Itali, banues ne Itali , me Karte Identiteti italiane Nr. CA71600DB

I cili sot krijon shoqerine e ka emertuar " CURRUNT" shpk "

Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe gezon te drejta e detyrime si person juridik shqiptar, qe prej dates ne te cilen kryhet rregjistrim i saj ne QKB.

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat themeluese (Akte themelimi dhe Statut).

#### NENI 2

##### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Veprimtaria e shoqerise:

- Zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i produkteve dhe sherbimeve inovative me vlere te larte teknologjike nepermjet :
- a) krijimit, prodhimit, menaxhimit, realizimit, zhvillimit, furnizimit dhe transmetimit e produkteve radiotelevizive, multimediale e produktet dixhitale me predispozicion krijimet inovative te proceseve inovative te proceseve te reja duke ndjekur zhvillimet evolutive ;
- b) furnizimit dhe mbeshtetjes per krijimin e cdo lloj montimi miksazhi me krijimin e teksteve dhe imazheve ;
- c) realizimit te softwareve per perkthimin e audio viziveve ne gjuhet ne perdorim ne sistemet radiotelevizive, multimedia dixhitale dhe provimi i krijimit inovativ te proceseve te reja qe vijojne teknologjike;
- d) realizimit, zhvillimit, menaxhimit dhe furnizimit te te tretet te sistemeve dixhitale radiotelevizive analoge si dhe te tipologjie teknologjike ekzistente dhe ne evolim ne aspektin e dispozitave ne fuqi;
- e) blerjes, planifikimit dhe realizimit pervec shitjeve e koncesione per licencen e perdorimit dhe nepermjet kanaleve tregtare e telematike te programeve software edhe te te treteve , te lidhur me sektorin radioteleviziv dhe informatik ;
- f) realizimit dhe zhvillimit te aplikimeve internet ose intranet; projektimi, realizimi dhe menaxhimi i programeve software dhe databaze;

*m*

- g) prodhimit, blerjes , shitjesdhe shprndarjes me cdo mjet te produkteve editorial , ne pergjithesi , realizimit , menaxhimit dhe furnizimit te te tretet te prograveve dhe permbajtjeve divulgative , publicitare , tregtare e cdo lloji me destinacion shperndarjen nepermjet shtypit , radiotelevizionit dhe WEB
- h) tregtimit me shumice dhe me pakice te softwereve ne format tradicionale me support magnetik ose nepermjet internetit , intranet ose mjeteve te tjera te transmetimit , imazheve dhe tingujve dhe tregtimit elektronik ne pergjithesi
- i) tregtimit , mirmbajtjes dhe asistences se paisjeve e sistemeve elektrike dhe elektronike, informatike dhe informacionit per komunikimin radioteleviziv ne pergjithesi per cdo teknologji ekzistuese dhe ne evolucion , trajtimit dhe transmetimit te imazhit , tingujve dhe te dhenave
- l) realizimit dhe zhvillimit te sajteve WEB dhe televizive per internet , intranet dhe evolucioneve teknologjike si dhe krijimit te softwareve perkatese te tregtimit online , grafika publicitare , menaxhimit furnitorit te zgjidhjeve per internet
- m) aktivitetit dhe vendosjes (hosting ) te faqeve të WEB, te te treteve te njësive (servers); konsesionit te serverit te lidhur me internet (housing) ; menaxhimit vendosjes se njesise Hardware te nderlidhura ( WEV farm ose Serverfarm)
- n) aktivitetit te permbledhjes publicitare te cdo lloji , perfshire sponsorizimetper llogari te vet apo llogari te te treteve;
- o) fitimit, menaxhimit, shfrytëzimit te te drejtave te imazheve te atleteve , sportistev e dhe profesionistev te llojeve te tjera e personave tve lidhur me boten multimediale
- p) studimit, projektimit dhe realizimit grafik e publicitar ne format letre e dixhitale .
  - Shoqeria mund te kryej ne cdo rast te gjitha veprimet e dhe operacionet kontraktore komerciale, imobiliare e finaciare qe do te gjykohen te arsyeshme nga administratoret per permbushjen e veprimtarise se shoqerise , me perjashtim te aktiviteve financiare me publikun .

### NENI 3

#### FORMA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar,per sa kohe qe Asambleja e Ortakeve nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne nje shoqeri tjetere.

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozita perkatese te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

### NENI 4

#### EMERTIMI

Ortaku ka vendosur qe shoqerine ta emertoje " **CURRENT** " shpk " ne te gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqeria ,emertimi i shoqerise do te ndiqet nga fjalet shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe inicialet SHPK.

### N E N I 5

#### KOHEZGJATJA

*Handwritten signature*

Shoqeria do te kete nje periudhe aktiviteti te pakufizuar

## **N E N I 6**

### **SELIA**

Shoqeria e ka seline ne Paskuqan, Paskuqan, Tirane , Rr. Sotir Andoni , Nr. 31

Pervec veprimtarise ne nivel Lokal shoqeria ka te drejten e krijimit dhe mbylljes se filialeve ,agjensive dhe zyrave te perfaqesimit brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise

Selia mund te transferohet ne cdo vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise me nje vendim te Asamblese se Ortakeve

## **N E N I 7**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali Themeltar i shoqerise perbehet nga te holla ne vlefte 100.000(njeqintmije)leke , nga te cilat :

Nr	Emri Mbiemri ortakeve	Pjese ne kapitalin	% ne kapital themeltar
1	<b>Renato BONORA</b>	1 PJESE	100 %

Kapitali eshte shlyer e nenshkruar teresisht .

Kuota e kapitalit fillestar eshte derdhur nga ortaku themelues ne Banke dhe eshte shenuar ne librin e llogarise se shoqerise

Ortaku ne te ardhmen mund te rrise apo zvogloje kapitalin themeltar te shoqerise.

## **N E N I 8**

### **LLOGARIA E SHOQERISE**

Viti ekonomik mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti dhe bilanci duhet te miratohet brenda tre muajve te vitit pasardhes.

## **N E N I 8**

### **BILANCI DHE VITI FISKAL**

Veprimtaria e shoqerise zhvillohet mbi bazen e leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj .

Viti fiskal i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik.

Bilanci i veprimtarise ekonomike te shoqerise duhet te perpilohet jo me vone se 31 Mars , pasues i vitit fiskal.

## **N E N I 9**

### **FONDET E TJERA TE SHOQERISE**

Shoqeria krijon fondet per zhvillimin e zgjerimin e veprimtarise se saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



Krijimi i fondeve dhe burimet e tyre financiare caktohen nga Asamblea e ortakeve .

## **N E N I 10**

### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE**

Ortakët kanë të drejta të cilat ushtrohen në përputhje me ligjin dhe aktin e themelimit .

- Marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin.
- Kërkojnë dhe marrin të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë dhe marrin çdo dokument të përpiluar nga shoqëria ( bilanci, libra llogarie etj. )
- Propozojnë dhe paraqesin me shkrim para asamblesë së ortakeve dhe organeve të tjera të shoqërisë.
- Të drejta të tjera që u njihen nga ligjet dhe aktet e themelimit.

Detyrimet e ortakeve janë:

- Të paguajnë kuotën e tyre të plotë dhe kuota të tjera suplementare në përputhje me aktin e themelimit dhe vendimet e shoqërisë.
- Marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara në bazë të akteve të themelimit .
- Të kryejnë detyrimet e ngarkuara nga organet e shoqërisë për realizimin e objektivave të shoqërisë.

## **N E N I 11**

### **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHOQËRISË**

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asamblea e ortakeve . Në Asambleë marrin pjesë ortakët , fuqia votuese e të cilëve është në përputhje me kontributin e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Asamblea e ortakeve nëpërmjet të tjerave vendos për këto probleme:

- Miraton bilancin vjetor të shoqërisë.
- Vendos për zmadhimin, zvogëlimin ose transferimin e kapitalit të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen ose likuidimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe për shndërrimin e saj në një formë tjetër të shoqërisë.
- Vendos për ndryshimet në statut dhe në aktin e themelimit.
- Vendos për çdo çështje tjetër që u paraqitet atyre nga organet e tjera të shoqërisë.

## NENI 12

### QUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e ortakeve thirret jo me pak se nje here ne vit . Lajmerimi behet 15 dite para dates se mbledhjes nga administratori dhe ne mungese te tij nga eksperti kontabel. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm Gjithashtu , cdo ortak qe perfaqeson te pakten 10% te kapitalit te shoqerise ka te drejte te kerkoje thirrjen e Asamblese .Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme Asambleja e jashtezakonshme thirret sipas rastit me kerkesen e ortakeve te shoqerise per zgjidhjen e problemeve imediate apo te rendesishme te shoqerise.

Qe mbledhjet e Asamblese te jene te vlefshme , ne te duhet te marrin pjese ortaket qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit te shoqerise.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakeve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit " Per Tregtaret e shoqerite Tregtare " për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

## NENI 13

### ADMINISTRIMI

Administratori i shoqerise ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise ne marredheniet me personat e trete.

Administratori pergjigjet individualisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete kur gjate veprimtarise se tij shkel ligjin , aktet e themelimit apo

kontratat e tjera ose per veprime te bera me faj gjate administrimit te shoqerise.

Emerimi dhe shkarkimi i tij behet me vendim te ortakeve qe perfaqesojne shumicen e thjeshte. Ne te njejten menyre vendoset edhe per kompensimin ne te holla per detyren qe kryen administratori i shoqerise.

Administrator i shoqerise per nje periudhe pesevjecare caktohet **Z. Renato BONORA** .

## NENI 14

### EKSPERTI KONTABEL



Per kontrollin e veprimtarise se shoqerise , do te caktohet nje ekspert kontabel. Ai emerohet nga Asamblea e ortakeve , e cila cakton edhe masen e kompensimit te tij.

Detyrat kryesore te ekspertit kontabel qe kryhen pa nderhyre ne administrimin e shoqerise jane:

- Te garantoje qe llogarite vjetore jane te rregullta e te hartuara me sinqeritet dhe japin nje pasqyrim besnik te rezultatit , te operacionave te vitit perkates financiar si dhe te gjendjes financiare , te trashegimise se shoqerise ne fund te vitit perkates financiar.
- Te verifikoje vazhdimisht librat e llogarise dhe fondet e shoqerise si dhe te kontrolloje pershtatjen e kontabiliteit te saj me legjislacionin ne fuqi.
- Te verifikoje sinqeritetin dhe perputhjen me llogarite vjetore te informacioneve te dhena ne raportin e administrimit nga ana e administratorëve dhe ne dokumentat e tjera qe u jane derguar ortakeve mbi gjendjen financiare dhe llogarite vjetore.

## **N E N I 15**

### **SHPERNDARJA OSE PRISHJA E SHOQERISE**

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj

b)me vendim te ortakut te vetem

c)me hapjen e procedurave te falimentimit

c)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723,date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

d)me vendim te gjykates

Ne kete rast Asambleja merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likujditorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese ,me perjashtim te rastve kur eshte nisur nje procedure falimentimi .


Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Asambleja .

Nese Asambleja nuk merr nje vendim per emerimin e likujduesit brenda 30 diteve pas prishjes ,cdo person I iteresuar mund ti drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidues

Likuiduesi merr persiper te drejtaqt dhe detyimet e administratorit nga data e emerimit te tij

## **NENI 16**

### **MARREDHENIET E PUNES**





Marredheniet e punes qe do te lindin ndermjet shoqerise dhe personave te punesuar prej saj do te rregullohen sipas Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise dhe kontratave perkatese te punes.

**N E N I 17**

**ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Per cdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet ortakeve apo ndermjet shoqerise me persona te trete, palet do te perpuiqen ti zgjidhin me rruge bisedimesh. Ne rast te kundert palet do ti drejtohen gjykates se rrethit gjyqsor Tirane dhe ligj i zbatueshem do te jete ai shqiptar.

**N E N I 17**

**DISPOZITA TE FUNDIT**

Per ceshtje te cilat nuk jane parashikuar ne kete statut ortaket do ti referohen dispozitave perkatese te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Statuti redaktohet ne tre ekzemplare , dhe nenshkruset nga ortaku pa verejtje , pasi kuptohet nga ortaku pas perkthimit nga gjuha shqipe ne italisht nga Fatmir LACEJ, perkthyes i autorizuar i gjuhes italiane

Tirane 14/12/2019

**ORTAKU SHOQERISE**

Renato BONORA

